



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:063214
Datë: 25.03.2025
Numri i dokumentit: 07039824

Ac.nr.7483/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit Bujar Dobërdolani dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëseve F. F. nga F., F.S. nga fshati M., F. I. nga F. dhe G.B. nga F. , të cilat ë përfaqëson me autorizim Rafiz Shehu, avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna e Ferizajit – Drejtoria Komunale e Arsimit , për shkak të kompensimit në emër të inflacionit në pagë mujore, vlera e kontestit 853.23 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, 2022:063215 të datës 12.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Ferizajit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm 2022:063215, i datës 12.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë më Aktgjykimin e ankimuar 2022:063215 të datës 12.08.2022 në pikën I., të dispozitivit e ka aprovuar kërkespadinë e paditëseve F. F. nga F., F. S. nga fshati M., F. I. nga F. dhe G. B. nga F. , ashtu që ka detyruar të paditurëun Komuna e Ferizajit – Drejtoria Komunale për Arsim që ti paguaj

1. F. F., në emër të inflacionit në pagë nga data 01.03.2019 deri me datën 31.12.2019 shumën prej 213.32 euro (shuma prej 50.58-euro sipas normës së inflacionit për vitin 2018 nga 1.1 %, shumën prej 150.64-euro për vitin 2020 dhe vitin 2019 sipas normës së inflacionit prej 2.7 %-euro dhe shumën prej 12.10-euro për vitin 2021 sipas normës së inflacionit prej 0.2%, shuma e përgjithshme prej 213.32 euro)
2. F. S. në emër të inflacionit në pagë nga data 01.03.2019 deri me datë 31.12.2019, shumën prej 213,32 euro (shuma prej 50,58 euro me normë inflacioni për vitin 2018 prej 1,1%, shuma 150,64-euro për vitin 2019 me normë inflacioni 2,7% dhe shuma 12,10-euro për vitin 2020 me normë inflacioni prej 0,2-euro gjithsej shume prej 213.32 euro).

3. F. I. në emër të inflacionit në pagë nga 1.03.2019 deri më 31.12.2019. shuma prej 213,32 euro (shuma prej 50,58 euro me normën e inflacionit për vitin 2018 prej 1,1%, shuma prej 150,64 euro për vitin 2020 dhe 2019 me normën e inflacionit prej 2,7% dhe shuma 12,10 euro për vitin 2021 me normën totale të inflacionit prej 2% shume e përgjithshme 213,32 euro) dhe
4. G. B. në emër të inflacionit në pagë nga data 01.03.2019 deri më datë 31.12.2019, shumën prej 213,32 euro (shuma prej 50,58 euro me normë inflacioni për vitin 2018 prej 1,1%, shuma 150,64 euro për vitin 2019 me normë inflacioni 2,7% dhe shuma 12,10 euro për vitin 2020 me normë inflacioni prej 0,2% gjithsej shuma e përgjithshme prej 213.32 euro)

Të gjitha me kamatë ligjore 8%, nga data e paraqitjes së padisë 31.03.2022 deri në momentin e pagesës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II., të dispozitivit obligohet i padituri që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 618.50 euro (26 euro për përpilimin e padisë, shumën prej 338.00 euro për seancat gjyqësore dhe shumën prej 20.50 euro në emër të taksës për padi, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij Aktgjykimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitivit të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i atakuar me ankesë të priset dhe çështja të dërgohet në gjykatën e shkallës së parë në rishiqim dhe rivendosje.

Paditëset, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, kanë ushtruar përgjegjësi në ankesë me propozimin që ankesa të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), si dhe nenit 201, pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, Rafiz Shehu, me datë 31.03.2022, kanë ushtruar padi kundër të paditurës për kompensim në emër të inflacionit në pagë me propozimin që gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyrohet e paditura që në emër të inflacionit në pagë t'i paguajë secilit nga paditësit shumën prej 213,32 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, duke thënë se paditëset, me rastin e shtrimit të padisë, nuk kanë specifikuar sa ishte norma e inflacionit për vitet pionit për vitet për të cilat kanë kërkuar që të kompensohen.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar 2022:063215 të datës 12.08.2022 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëseve duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se gjykata në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është konstatuar fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, nga lista e pagave në emër të paditësve gjykata kontatoi faktin se paga neto e paditëseve është 471,47 euro, ndërsa nga raporti i Agjencisë së Statistikave për normën e inflacionit, gjykata ka përcaktuar se norma e inflacionit për vitin 2021 ishte 0.2%, për vitin 2020 ishte 2.7%, dhe për vitin 201 norma e inflacionit ishte 1.1%. Gjykata e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke e mbështet vendimin e saj në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosi sipas nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimin i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se aktgjykimin është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse që vërtetojnë së pari faktin se paditëset janë të punësuar tek e paditura . Gjithashtu gjykata e ka vërtetuar pagën bazë që kanë paditësit, përmes listës së pagave, pastaj edhe shkallën e inflacionit për secilin vit përkatës që kanë kërkuar paditëset për këtë lloj të kompensimit. Në këtë mënyrë përqindjet e inflacionit që janë publikuar nga Enti i Statistikave të Kosovës, paraqesin bazë të besueshme për matjen e shkallës së inflacionit, për secilin vit përkatës. Në këtë mënyrë nuk është gjetur si i bazuar pretendimi ankimor për sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, që nënkupton se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka interpretuar ndonjë fakt sipas provës përkatëse, apo se gjendjen faktike nuk e ka vërtetuar fare, në atë mënyrë që ka qenë dashur të merrte një provë e cila do të vërtetonte plotësisht gjendjen faktike. Si rrjedhojë e fakteve të provuara, gjykata e shkallës së parë ka arritur që drejtë të aplikoj të drejtën materiale, kur paditëses i ka njohur kompensimin në emër të përqindjes së inflacionit,

në përputhje me nenin 35 par 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilit “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Rregullim të ngjashëm ka paraparë edhe Kontrata kolektive pasuese e nënshkruar me datë 22.01.2021.

Nga interpretimi i dispozitave të Kontratës Kolektive dhe fakteve të provuara, kjo gjykatë arriti në përfundim se paditësja ka të drejtë të kompensohet në shkallë të caktuar të përqindjes në emër të inflacionit, edhe në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’i kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit. Të drejtën në kompensim të inflacionit, që i përket kategorisë së paditëses, e ka konfirmuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës, përmes mendimit juridik të datës 09.10.2023.

Gjykata, pretendimet ankimore të paditurës, se nuk kanë obligim ligjor që të kompensojnë pagesën e inflacionit i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore kanë filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMDsë, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e lënë të pashqyrtuar pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit të ankimit me të cilën padia e paditëses kundër të paditurës së dytë është konsideruar e tërhequr.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7483/2022, me datë 25.03.2025

**Kryetar i kolegjit,
Ardian Ajvazi**